



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:014338
Datë: 20.09.2024
KA.nr.722/22
Numri i dokumentit: 06252725

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NPT “Union”, me seli në Mitrovicë, e përfaqësuar nga Avokat Leutrim Ademi, kundër të paditurave 1. Organi Shqyrtues i Prokurimit, me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga Erlehta Popaj dhe 2. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit PSH.nr.1120/20 i datës 22.01.2021, pas shqyrtimit kryesor publik me datë 05.09.2024, në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, Avokat Leutrim Ademi, në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar të paditurës OSHP, Erlehta Popaj dhe në mungesë të përfaqësuesit të paditurës, MASHT, përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, me datë 20.09.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit NPT “Union”, me seli në Mitrovicë, kundër të paditurës 1. Organi Shqyrtues i Prokurimit, dhe 2. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me çka ka kërkuar të anulohet vendimi PSH.nr.1120/20 i datës 22.01.2021, pas shqyrtimit kryesor publik me datë 05.09.2024, si e pabazuar.

- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Me datë 27.01.2021, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, paditësi NPT “Union”, me seli në Mitrovicë, e përfaqësuar nga Avokat Leutrim Ademi, kundër të paditurave 1. Organi Shqyrtues i Prokurimit, me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga Erëlehta Popaj dhe 2. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, ka parashtruar padi për shkak të anulimit të vendimit PSH.nr.1120/20 i datës 22.01.2021, me propozim që Gjykata të aprovoj si të bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, të anulojë vendimin e kundërshtuar dhe të konstatoj se paditësi ka plotësuar kriteret e përcaktuara tenderuese dhe të shpallet përfitues i tenderit. Lënda është evidentuar me nr. A.192/21.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr.722/22.
3. Seanca e shqyrtimit kryesor publik u mbajt me datë 05.09.2024, në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, Avokat Leutrim Ademi, me autorizim të datës 26.01.2021, në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar të paditurës 1. OSHP, Erlehta Popaj, dhe në mungesë të përfaqësuesit të paditurës 2. MASHT, përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore të ftuar në mënyrë të rregullt, konform nenit 41 të LKA-së, ftesën për seancë dhe kopjen e procesverbalit të datës 23.08.2024, e ka pranuar me datë 30.08.2024, ftesës nuk i është përgjigjur dhe mungesën nuk e ka arsyetuar.

Pretendimet e paditësit

4. Paditësi sipas procedurës së tenderimit ka aplikuar për tender për shërbimet e transportit të nxënësve, Paditësi në fazën e parë është përzgjedhur fitues i tenderit duke plotësuar kushtet dhe kriteret e parapara nga autoriteti kontraktues, MASHT. Kurse, pas ushtrimit të ankesës, OSHP, e ka kthyer lëndën në rivlerësim ku autoriteti kontraktues e ka shpallur si fituese të tenderit një operator tjetër ekonomik.
5. Paditësi ka ushtruar ankesë me datë 18.12.2020, Ndërsa e paditura OSHP, me Vendim PSH.nr.1120/20 i datës 22.01.2021, ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit ndërsa ka vërtetuar njoftimin për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit me titull

“Shërbimet e Transportit për QB Nëna Terezë Mitrovicë Jugore dhe shkolla speciale Buzhuri i Kosovës në Mitrovicën e Veriut”.

6. Pala paditëse konsideron se arsyetimi i Organit të Prokurimit se paditësi nuk ka plotësuar kushtet e parapara nuk qëndron sepse paditësi ka qenë bashkëpunues dhe ka ofruar të gjitha provat e nevojshme lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike në të dy procedurat dhe në nxjerrjen e ekspertizës. Konsideron se është bere konstatim jo i saktë i gjendjes faktike nga ana e ekspertit sepse në përshkrimin e librezës shënohet se ka vetëm 1 vend për persona me aftësi të veçanta e jo HEBEBI, i cili është mjete kryesor që shërben për hipjen dhe zbritjen në kombi-bus për persona me aftësi të veçanta. Në dosje të tenderit, paditësi, posedon vërtetim për posedimin e pajisjes HEBEBI, të cilin mjet nuk e posedon fituesi i tenderit apo të paktën nuk posedon dokumentet në dosje. Komisioni vlerësues herën e parë e ka cilësuar si të papërshtatshëm operatorin e tanishëm ekonomik me arsyetim se nuk ka pasur përvojë më herët për transportin me nevoja të veçanta, që ishte kriter i përcaktuar.
7. Pala paditëse kundërshton ekspertizën sepse e paditura ka deklaruar se paditësi nuk i ka plotësuar kushtet e kërkuara kurse paditësi ende i bart nxënësit me mjete që posedojnë HEBEBI, mjete këto prej 8-10 ulëse e deri në 20 ulëse, të cilat veçanërisht kanë shërbyer në kohën e pandemisë për mbajtje të distancës. Pala paditëse konsideron te pa shpjegueshëm konstatimin kontradiktor të paditurës se mjetet me ulëse nga 8-10 janë më të ngushta se ato me 20 ulëse e që plotësojnë kushtet për rrugë të fshatrave.
8. Pala paditëse konsideron se aplikim tjetër i gabuar i dispozitave ligjore është se e paditura nuk i ka vërtetuar kundërshtimet dhe pretendimet e paditësit në E-mail zyrtar të datës 02.01.2021, gjë që vërtetohet nga arsyetimi i vendimit sepse nuk përmenden cilat kritere i ka plotësuar operatori tjetër ekonomik por të gjitha pretendimet refuzuese janë përmendur karshi paditësit.

Kundërshtimet e të paditurave

9. E paditura Organi Shqyrtues i Prokurimit, në përgjigje në padi të datës 29.04.2024 deklaroi se pretendimi ankimor i paditësit se AK nuk ka vepruar sipas nenit 6 të LPP

është i pabazuar sepse ne nenin e përmendur qartësohet se operatori më i lirë i përgjegjshëm duhet të shpërblehet me kontratë pra kjo dispozitë obligon autoritetin kontraktues që të arrij ekonomizimin dhe efikasitetin që nënkupton të paguaj çmimin më të lirë kur operatorët ekonomik i përmbushin kërkesat e dosjes së tenderit ku në këtë rast paditësi nuk posedon kombi sipas kërkesës së AK sepse disa kombi janë me ulëse mbi 20 vende. AK kishte kërkuar kombi prej 8 deri 10 vende për shkak të rrugicave dhe rrugëve të ngushta në fshatra.

10. Deklaron se Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues ka konstatuar se AK ka vepruar konform nenit 28 të LPP sepse Paditësi nuk ju ka përmbajtur të gjitha specifikimeve të detyrueshme teknike në dosjen e tenderit, sepse ka poseduar vetëm 4 kombi me 8-10 ulëse kurse kërkesa e AK ka qenë posedimi i 6 kombi bus me 8-10 ulëse. Pretendimi ankimor se AK ka shkelur nenin 60 të LPP se kriteri kryesor është çmimi më i ulët i ofruar është në kundërshtim të plotë me nenin 66 dhe 69 të njëjtit Ligj sepse bazuar edhe në përgjigjen e ekspertit për OSHP, vërehet që operatorët Joni dhe Dita nuk kanë aftësi profesionale që ta përmbushin këtë tender pasi që nuk kanë përvojë të njëjta më herët dhe nuk posedojnë mjete të punës, Kombi dhe HEBEBI. OSHP i propozon Gjykatës ta refuzojë si të pabazuar padinë e paditësit dhe të vërtetohet si i ligjshëm vendimi i kontestuar bazuar në dispozitat e LPP.
11. Pala e paditur 2. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me përgjigje në padi të datës 25.04.2024 e konteston në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin se vendimi i atakuar është marr konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë dhe i propozon Gjykatës që të refuzojë kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pabazuar.

Provat e administruara

12. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendimi i kundërshtuar me numër PSH.1120/20 i datës 25.01.2021; Ankesë e paditësit NTP "Union" kundër vendimit të autoritetit kontraktues e parashtruar me datë 21.12.2020; Kundërshtim i paditësit në konstatimet e raportit të ekspertit, parashtrësia pa datë me nr.prot.1120/20; Vendimi i autoritetit kontraktues i datës 09.10.2020; Draft kontrata publike në mes të AK dhe grupit operator fitues; Dosja e tenderit për kontratën

publike kornizë të datës 08.07.2020 për aktivitetin e prokurimit me numër 209-udhëheqësi-20-3492-2-2-1; Kontrata kornizë me autoritetin kontraktues për aktivitetet e prokurimit të njëjte për periudhën 16.05.2024 deri me datën 16.05.2025; Kontrata publike kornizë e datës 28.09.2018.

Vlerësimi i Gjykatës

1. Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e njoftimit të goditur me padi në kuptim të nenit 99 par. 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe nenin 56 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, i cili përcakton se: 3. *Të gjitha vendimet e nxjerra nga OSHP mund të shqyrtohen nga Gjykata kompetente në pajtim me ligjin për shqyrtimin gjyqësor të çështjeve administrative* si dhe në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative cili përcakton: “Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.
13. Me vendimin e kundërshtuar PSH. 1120/20 të datës 25.01.2021, aprovohet pjesërisht e bazuar ankesa e Grupit të Operatoreve Ekonomik, NTP “Union” Mitrovicë, kundër njoftimit për dhënje të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me nr. 20-3492-2-2-1, me titull “Shërbimet e Transportit për QB Nëna Terezë Mitrovicë Jugore dhe shkolla speciale Buzhuri i Kosovës në Mitrovicën e Veriut”, dhe vërtetohet njoftimi i AK-së. Sipas arsytimit AK ka kërkuar kombi me ulëse prej 8 deri ne 10 vende për shkak të rrugicave te ngushta në fshatra, ndërsa ka konstatuar se OE “Union” ka ofruar kombi me 20 ulëse, ndërsa posedon vetëm 4 kombi që përshtaten kërkesës së AK, nga AK janë kërkuar 6 kombibus. Prandaj pretendimi për shkelje të nenit 6 të LPP-së është i pabazuar. OE Union ka deklaruar se në kërkesën e AK për kombi me pjerrinë dhe Bebebi, mund të kërkohet sqarim nga qendra e Homologimit të Automjeteve se pse nuk është shënojnë në librezë se mjeti posedon pjerrinë dhe ka ofruar që të bëhet shikimi i kombit nga A. Paneli shqyrtues, duke u bazuar edhe ne konstatimin e eksperti, ka vlerësuar se OE “Union” edhe pse ka ofertuar me çmim më të ulët nuk i plotëson kushtet e përshtatshmërisë.

14. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoi provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpapia e paditësit është e bazuar, sepse paditësi nuk i ka plotësuar kërkesat e përcaktuara me dosjen e tenderit. Nga Fleta e të dhënave të tenderit gjykata konstaton tek kërkesat për mundësitë teknike dhe profesionale AK, ka specifikuar pika 9.1 dhe 9.2, 2. Duhet të posedoj 6 kombibus dhe për dëshmi duhet të ofroj dëshmi se posedon mjete të mjaftueshme: 5 kombibus të jenë normal, një kombibus duhet te kete pjerrine... kombibusët duhet të jenë të vegjël 8-10 ulëse, sepse duhet te merren nxënësit nëpër rrugica të ngushta.
15. Paditësi edhe në pretendimet e ngritura në padi nuk e ka mohuar faktin se i njëjti ka aplikuar në procedurë të prokurimit me mjetet transportuese së posedojnë deri në 20 ulëse, për të cilat ka deklaruar se kanë shërbyer për bartjen e nxënësve në kohën e pandemisë për mbajtjen e distancës.
16. Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Neni 28 paragrafi 2 përcakton *Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.*
17. Gjykata vlerëson se specifikimet e dhëna nga AK në Fletën e të dhënave të tenderit gjykata që *kombibusët duhet të jenë të vegjël 8-10 ulëse*, me arsyetim sepse duhet te merren nxënësit nëpër rrugica të ngushta, janë bërë për qëllim të aktivitetit të prokurimit dhe nuk kanë për qëllim trajtimin e pabarabartë, diskriminimin apo përjashtimin e ndonjë operatori ekonomik.
18. Prandaj gjykata konstaton se vendimin i kundërshtuar PSH. 1120/20 të datës 25.01.2021, është i drejtë dhe i ligjshëm sepse OE "Union" nuk i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit, të përcaktuara nga AK për nevoja të aktivitetit të prokurimit me nr. 20-3492-2-2-1, me titull "Shërbimet e Transportit për QB Nëna Terezë Mitrovicë Jugore dhe shkolla speciale Buzhuri i Kosovës në Mitrovicën e Veriut", për çka AK kishte kërkuar kombi me ulëse prej 8 deri ne 10 vende për shkak të rrugicave te ngushta në fshatra. Gjykata

vlerëson se provat e tjera të administruara si Ankesë e paditësit NTP “Union” kundër vendimit të autoritetit kontraktues e parashtruar me datë 21.12.2020; Kundërshtim i paditësit në konstatimet e raportit të ekspertit, parashtrës pa datë me nr.prot.1120/20; Draft kontrata publike në mes të AK dhe grupit operator fitues; Kontrata kornizë me autoritetin kontraktues për aktivitetet e prokurimit të njëjtë për periudhën 16.05.2024 deri me datën 16.05.2025; Kontrata publike kornizë e datës 28.09.2018, nuk ishin relevante për vërtetimin e ndryshe të gjendjes faktike, sepse paditësi nuk vërtetojnë se paditësi i ka plotësuar kërkesat teknike dhe profesionale.

19. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 par. 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Vendimi lidhur shpenzimet procedurale u vendos në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.722/22, me datë 20.09.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.